



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

**RAPORT PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 65/2014 “PËR  
AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES”**

**1. Titulli i draft aktit**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.

**2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.*

Konsultimi paraprak i këtij dokumenti ka nisur brenda institucionit që në fazën e hartimit të draftit fillestar dhe komentet/sugjerimet janë finalizuar në versionin e parë të këtij dokumenti.

Dokumenti u publikua në RENJK në adresën “[konsultimipublik.gov.al](http://konsultimipublik.gov.al)”, në datën 16.01.2024 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 13.02.2024, duke respektuar afatin prej 20 ditë pune.

**3. Metoda e konsultimit**

*Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).*

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 65/2014 “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes” u konsultua:

- **Nëpërmjet publikimit në RENJK;**
- **Nëpërmjet adresës së emailit:** [konsultim.publik@mod.gov.al](mailto:konsultim.publik@mod.gov.al):

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas drafteve të projektligjit është vënë në dispozicion edhe një adresë elektronike.

- **Nëpërmjet adresës postare: “Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë:**

Çdo palë e interesuar pati mundësinë të dërgojë në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

- **Nëpërmjet zhvillimit të takimeve të drejtpërdrejta:**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Diskutimet lidhur me këtë projektligj janë zhvilluar gjatë takimeve në mbledhje grup pune.

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

*Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.*

*Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.*

*Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.*

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projektakti janë:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

#### **5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;*

*Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;*

*Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Projektligji është dërguar për mendim pranë nëpërmjet sistemit eAkte, komente te :

- **Ministrisë së Financave**
- **Ministrisë së Brendshme**
- **Shërbimit Informativ të Shtetit**
- **Ministrisë së Drejtësisë**
- **Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**
- **Departamentit të Administratës Publike**

Komentet e ardhura nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera janë gjeneruar nëpërmjet sistemit eAkte.

Në përfundim të konsultimit publik për këtë projektligj, nuk ka patur komente/sugjerime në asnjë prej metodave të konsultimit (RENJKP, takime konsultative, postë elektronike dhe shkresore).

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e...,	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
---	---	--	---	-------------

<i>rregullimi i...</i> <i>etj.)</i>	<i>të interesuara së</i> <i>bashku)</i>			
--	--	--	--	--